Kronikë

Shpërthimi në 2020 në pallatin në ndërtim të biznesmenit Liman Gjoka në Lezhë, në pranga porositësi

3 vite e gjysmë pas shpërthimit me tritol në objektin në ndërtim të biznesmenit Liman Gjoka në zonën e Ranës së hedhur në Shëngjin, policia e Lezhës ka arrestuar një person të dyshuar si porositës i ngjarjes.

Ndërtesa ku ndodhi shpërthimi

Redaksia
28 Mars, 07:54 | **Përditesimi: 28 Mars, 09:47**

3 vite e gjysmë pas shpërthimit me tritol në objektin në ndërtim të biznesmenit ***Liman Gjoka*** në zonën e Ranës së hedhur në Shëngjin, policia e Lezhës ka arrestuar një person të dyshuar si porositës i ngjarjes.Zef Kola banues ne Tirane është ndaluar me urdhër te prokuronit të çështjes Françesk Ganaj, i cili pas hetimeve me metoda speciale ka arritur te zbardhë plotësisht këtë ngjarje. Si autor te vendosjes se lëndës plasëse me herët janë dënuar me burg nga gjykata e Lezhës dhe 2 autoret Erald Pajtani me 4 vite burg dhe Angli Stafuka me 2 vite heqje lirie. Zef Kola u ndalua nga Policia e Lezhës me urdher të prokurorit të çështjes Françesk Ganaj, në kuader të operacionit "Eksplozivi"

Kujtojmë se ngjarja e rëndë ***ndodhi më 20 nëntor.*** Kjo ishte hera e parë e cila u ndoq nga një shpërthim i dytë në ***harkun kohor të 3 javëve***, kur u sulmua serish me lëndë plasëse objekti në fjalë.Në dëshminë e tij në polici biznesmeni Liman Gjoka ka deklruar se pronën ku po ndërton e ka blerë shumë vite më parë dhe se nuk ka asnjë konflikt. Por pavarësisht pretendimeve të tij pista krysore e hetimit është ajo e konflikteve të pronësise, por nuk përjashtohet mundësia se ngjarjet mund të kenë ardhur dhe për shkak të konkurencës.

LEXO EDHE:
Përplasja e autobusit të Lundrës në Tiranë me 3 të plagosur, në pranga drejtuesi! Policia: Shoferi shkeli rregullat e qarkullimit

Biznesmeni Liman Gjoka po ndërtonte hotel dhe apartamente për shitje në bregun e detit në zonen e ranës së hedhun në Shëngjin. Kjo zonë turistike mjaft e lakmuar është kthyer në kantier ndërtimi, pas miratimit të planit strategjik të zhvillimit të saj.

Biznesmeni Liman Gjoka

G.MO/Shqiptarja.com

TAG: Lezhe | Tirane | Liman Gjoka | zef kola | erald pajtani | angli stafuka

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Kush mendoni se qëndron mbrapa sulmit ndaj Top Channel?

Pronarët sherr | Investigimet | Lufta politike

Lajme të tjera

Veliaj prezanton Zonën e Lirë Ekonomike për Tiranën: Do gjenerojë 5 deri në 7 mijë vende pune të mirëpaguara
28 Mars, 13:35



Rikandimi i Ndrec Dedës për Bashkinë Mirditë, jep dorëheqjen kreu i PS në Rubik: Bën fushatë me njerëz me precedent penal! Vjen në punë 2 herë në javë nga 2 orë
28 Mars, 12:59

E premtoi Belind Këlliçi, zbulohet studimi i ekspertëve gjermanë të GIZ-it: Jo transport publik falas në Tiranë, kostoja e tepërt! S'mund t'u merren paratë projekteve
28 Mars, 12:06

Degradimi i rrugës në Fushë-Milot, banorët në protestë, kërcënojnë me bllokim total nëse nuk merren masa: Kanë 10 ditë afat

Elvis Hila

28 Mars, 11:01

Sulmi me armë në Top Channel, policia: 100.000 € për këdo jep informacion për autorët! Pyeten pronarët: S'kemi pasur kërcënime, s'kemi të dyshuar
28 Mars, 10:20

Tokat e tyre preken nga ndërtimi i aksit Thumanë-Kashar, banorët e Bërxullës sërish në protestë: Shteti të negociojë me ne
28 Mars, 10:12

Sulmi në Top Channel, policia shoqëron ish-dhëndrin e Pal Kolës dhe një person tjetër, por lirohen! Dëshmia: S'kemi lidhje me ngjarjen
28 Mars, 07:36

Rrumbullaku mbledhje disa orë për sulmin në Top Channel! Gjenden prova të vlefshme, do të analizohen për profile ADN-je
27 Mars, 20:51

Veliaj prezanton listën e anëtarëve të Këshillave Bashkiak: Synojmë 40 vende! Mosha mesatare nën 35-vjeç! Për herë të parë përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian
27 Mars, 16:47

Belind Këlliçi vijon me gjuhën raciste: Kush hyn në Tiranë, do të paguajë
27 Mars, 16:21

'Vendoret' e 14 majit/ Nisma Thurje dorëzon listën në KQZ, kandidatë për këshillitarë bashkiakë në 10 bashki! Vetëm një kandidat për kryebashkiak
27 Mars, 16:12

Tentuan të vrisnin të riun në Rreshën, arrestohet një prej autorëve! Në kërkim i biri dhe nipi
27 Mars, 15:51

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje